

ANKESË

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Oper. Sistemi, Trans. dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Renovime dhe punë ndërtimore në nënstacione**

Nr i Prokurimit	KOSTT-25-2068-5-1-1
Nr i brendshëm	KOSTT(023/105,023/151,023/152,023/153)-25-09-511

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

U – UNIQUE SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. HOLGER PETERSEN P.N.

(Adresa)

PRISHTINË

(Vendi)

044 / 664 – 220

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

///

(Numri i Faks-it)

ULPIAN TAHIRI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

uunique.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

30.04.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vulë)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Njoftimi për Kontratë, në E-Prokurim. – 18.03.2025
2. Lloji i kontratës: Kontratën publike – Punë
3. Kriteri për dhënien e kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët;
4. Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve – 30.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ Jo ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e LPP-se që janë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë:

- Neni 7 – Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminimi
- Neni 28 i LPP-së - Specifikimet teknike (pikat 2,3,4,5)
- Neni 51 i LPP-së - Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes
- Neni 69 i LPP-së- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 18.16 RRUOP-se - Është e ndaluar përgatitja e Dosjes së Tenderit në një mënyrë që favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë Operatorëve Ekonomik potencial

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Shtojca: Kriteri

Për LOT1 duhet të Prezantohet Katalogu për Ormanin e ndriçimit, sipas përshkrimit në Specifikimin teknik

- Kjo kërkesë e AK-së nuk do të duhej të paraqitej duke e pas parasysh se ormanët e ndriçimit janë prodhime vendore dhe se janë produkte të përbëra nga punimi i llamarinave me trashësi të ndryshme. Andaj katalog të veçant për këtë produkt nuk mund të gjendet në tregun vendor e as atë të jashtëm dhe si e tillë nuk do të duhej të ishte kërkesë e në DT.

Për LOT1 duhet të Prezantohet Katalogu për trupat ndriçues dhe dritare sipas përshkrimit në Specifikimin teknik

- Duke i analizuar specifikat teknike të trupave ndriçues vërejmë se këta trupa ndriçues janë trupa që nuk mund të gjenden më në treg sepse janë të vjetër dhe tregu ka evoluar me ç'rast duke i përshtatur kërkesat e tregut për energji efikiente edhe ndriçimi në terësi i ka ndryshuar specifikat për të arritur maksimumin e efikasitetit. Andaj trupat ndriçues të kërkuar nga AK i përkasin të kaluarës.

Për LOT1 duhet të Prezantohet katalogu për dysheme, me rrëshirë polimer - dysheme epokside me trashësi $t=2 - 3$ mm sipas përshkrimit në Specifikimin teknik

- Kjo kërkesë tek (9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale) bie ndesh me shpëcifikimin teknik sepse dyshemeje nga epoksi përbëhen nga disa materiale dhe si terësi të një produkti (dysheme nga epoksi) nuk mund të kompletohet.

Për LOT2 Operatori ekonomik(OE) duhet të sjellë dëshmi që ka në pronësi ose ka kontratë për marrje në shërbim të pajisjeve dhe mekanizmave të obligueshëm për realizimin e projektit: ku si dëshmi ka kërkuar: **Ofertuesi të dorëzoj si dëshmi Deklaratë të nënshkruar me Shënimet identifikuese për secilën pajisje**

- Kjo kërkesë e AK-së në lidhje me dëshmit për pajisje me vetëm një deklaratë po krijon hamendësim sepse dëshmit për pajisjet e kërkuara nuk mbulohen vetëm me deklarata m'përpo aty ka kërkuar pajisje që mund të regjistrohen ose doganohen dhe kërkesa do të duhej të ishte më specifike dhe jo në këtë formë.

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Ju si AK me qëllim që të respektimit te nenit 7 ne kërkesat (9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale) nuk do të duhej ta kufizonit konkurrencën përmesë kriterëve të kërkuara në Njoftimin për Kontratë dhe në DT.

Ky veprim i bie ndesh edhe me nenin 17 të RRPP-001/2022 pika 17.17 ku thuhet:

17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Përfundim: Për shkak të kërkesave të shumëta dhe pa asnjë bazë ligjore ju si AK jeni duke tentuar të kufizoni konkurrencën dhe të favorizoni O.E. të caktuar ku me anë të këtyre veprimeve jeni duke e prolonguar aktivitetin në fjalë ku dihet që për herën e 5-të jëni duke e publikuar LOT 1 dhe për herë të 2-të LOT 2. Anda kërkojmë që t'i merrni parasysh dhe të bëni korrigjimin e këtyre kërkesave

Përfundim i pretendimit ankimor.

Nga te gjitha te cekurat me larte, konstatojmë se kërkesat në njoftim për kontrate dhe ne dosje te tenderit (DT) kufizojnë konkurrencën e lire dhe fer për projektin e lartëcekur.

Ne kërkojmë nga i Autoriteti Kontraktues qe ne përputhje me nenin 108A ta beje Rishqyrtimin e këtyre kërkesave dhe te përpiloj kërkesa relevante për projektin ne fjale duke mos kufizuar konkurrencën e lire dhe te sinqertë, kërkojmë qe te hiqen kushte dhe kërkesat qe kemi cekur me lart, dhe te bej ndryshim plotësimet e nevojshme ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nga kufizimi i konkurrencës na pa mundësohet konkurrenca e lirë dhe fer ne këtë projekt, me ç'rast përveç mundësisë që të shpërblehemi me kontratë neve ne këtë fazë po na kufizohet edhe pjesëmarrja.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*